




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

Njësia e Prokurimit

Gjiilan, me datë: 05.08.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjiilanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të dt. **03.08.2020**, të parashtruar nga **OE K.N.T.SH. "Teuta - M" Sh.p.k.** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "**Ndërtimi i kanalizimit fekal / Kanalizimi fekal në rrugën Metush Krasniqi L = 910.00m , dhe Kanalizimi Atmosferik rruga Lot Vaka L = 152.00m**", me nr të prokurimit **651-20-2685-5-2-1** dhe numër të brendshëm i prokurimit: **GL 651 20 027 521** nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** - kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomikë **OE K.N.T.SH. "Teuta - M" Sh.p.k.** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "**Ndërtimi i kanalizimit fekal / Kanalizimi fekal në rrugën Metush Krasniqi L = 910.00m , dhe Kanalizimi Atmosferik rruga Lot Vaka L = 152.00m**", me nr të prokurimit **651-20-2685-5-2-1** dhe numër të brendshëm i prokurimit: **GL 651 20 027 521** e dt. **03.08.2020** kundër Njoftimit për Kontratë dhe DT të datës **10.01.2019** të publikuar në platformën e prokurimit elektronik.
2. **AK - Komuna e Gjiilanit vendos të vazhdojë sipas** Njoftimit për Kontratë dhe DT të datës **10.01.2019**
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <http://e-prokurimi.rks-gov.net>

A r s y e t i m

Operatori Ekonomikë **OE K.N.T.SH. "Teuta - M" Sh.p.k.**, me datë **03.08.2020**, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "**Ndërtimi i kanalizimit fekal / Kanalizimi**

fekal në rrugën Metush Krasniqi L = 910.00m , dhe Kanalizimi Atmosferik rruga Lot Vaka L = 152.00m ", me nr të prokurimit 651-20-2685-5-2-1 dhe numër të brendshëm i prokurimit: GL 651 20 027 521. Autoriteti Kontraktues me datë 05.08.2020 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Autoriteti Kontraktues Kuvendi Komunal Gjilan në DT si dhe në Njoftimin për Kontratë të datës 02.07.2020 më saktësisht tek Aneksi nr. 1 kërkohet nga Operatorët Ekonomik që ti përmbahen kësaj të fundit :

Sipas pretendimeve tuaja, më saktësisht tek Pretendimi nr. 1 :

Ing. i Hidroteknikës dhe Ndërtimtarisë nuk kanë përvojë pune mbi 5 vite siç është kërkuar në dosje të tenderit.

- Sipas këtij Pretendimi tuaj, AK ka konstatuar se Grupi i OE të shpallur fitues në ofertën e tyre të dorëzuar figurojnë 2 (dy) Ing. të Ndërtimtarisë të cilët janë Z. Emin Hajdin Dragusha ku Diploma e tij Universitare daton me datë 30.09.1988 si dhe Z. Shaban Ramadan ku Diploma e tij Universitare daton me datë 06.03.2006. Dhe, duke u bazuar në Diplomën Univeristare, ku të bashkangjitur sipas kërkesës së DT dhe Njoftimit për kontratë që është kërkuar të kenë nga 5 vite përvojë pune. Ku, këta të fundit dhe e plotësojnë këtë kërkesë pasi që kanë ofruar dëshmi të Mjaftueshme.

Pretendimi nr. 1.2 :

Ingjineret dhe stafi i angazhuar së bashku me mjeshtrit e kërkuar, nga anëtarët e konzorciumit nuk kanë referenca adekuate nga palët e treta siç është kërkuar.

- Sipas Dëshmisë së DT më saktësisht Dëshmia 2. Për stafin teknik duhet te dorëzohen CV-a, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt. Referenca për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit për udhëheqësin e punishtes. Bazuar në këtë, ashtu siç është kërkuar në DT dhe në Njoftimin për Kontratë në ofertën e këtyre të fundit figurojnë Referenca të mjaftueshme ashtu siç është kërkuar nga AK.

Pretendimi nr. 1.3 :

Stafi profesional i propozuar nga Konzociumi fitues mjeshtrin e Armiruesit, nuk e ka certifikatën siç është kërkuar mirëpo vetëm një vërtetim për trajnim, dhe atë në lëmin e Ndërtimtarisë dhe jo adekuat në Armaturë dmth Armirues, pasi Qendrat e Trajnimit janë specifike në lëmit e veta në Kosovë për secilën lëmi, dhe jo në përgjithësi vetëm ndërtimtari.

- Sipas Ofertës së dorëzuar figuron Z. Sami Rashiti ku me datë 16.10.2006 është certifikuar në Ndërtimtari ku në atë certifikatë përfshihet më saktësisht Beton,Arme,Latues. Rrjedhimisht, OE ka plotësuar këtë kërkesë.

Pretendimi nr. 2.1 :

Kozurciumi fitues nuk e plotëson kriterin e makinerisë, pasi që tek kërkesa për eskavator nuk e plotëson kriterin e kërkuar për : Eskavator me zingjir gome prej 8-10 t .

- Në Kërkesën 3. Operatori Ekonomik duhet te posedojë mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit. Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT. Dhe si Dëshmia 3 Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet qe nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit

për automjetet qe regjistrohen. Ne rastet kur OE ka marrëveshje për shfrytëzimin, Grupi i OE duhet te dorëzoj edhe marrëveshjen për shfrytëzim. Është kërkuar Eskavatora me zingjir gome (per mos demtim te infrastuktures gjate punes) me peshe 8-10 ton. Andaj, si Dëshmi OE ka dorëzuar Eskavator me rrota i përdor me peshë neto 10,000.00 Kg ku, e ka plotësuar këtë kërkesë.

Pretendimi nr. 2.2 :

- Në Kërkesën 3. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit. Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT. Dhe si Dëshmia 3 Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet qe nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet qe regjistrohen. Ne rastet kur OE ka marrëveshje për shfrytëzimin, OE duhet te dorëzoj edhe marrëveshjen për shfrytëzim. Është kërkuar Makineria për montimin e pllakave me sistemin e vakumit. Për këtë Pretendim tuaj, Grupi i OE i shpallur fitues në ofertën e tij të dorëzuar figuron për këtë Marrëveshje Bshkëpunimi në mes Kompanisë “ Sky Group SGS “ dhe kompanisë “ EL BAU “ sh.p.k. si dhe të bashkangjitur ka dhe Kontratën mbi Shit Blerjen e kësaj Makinerie në mes Dardan Fetahi dhe “ Sky Group SGS “ sh.p.k.

Andaj, bazuar në të gjitha që u cekën më lartë AK- Komuna e Gjilanit i hedh poshtë të gjitha pretendimet e juaja ankimore.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesëankesë pranë OSHP-së . Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Izet Kurteshi



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës.